




Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 408

Data: 12.01.2024

PROCESVERBAL I RAPORTIT TË PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2023

Takimi i dytë me qytetarët

Procesverbali nga Raporti i punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023, të mbajtur me datën 26.12.2022, duke filluar nga ora 10:30 në Sallën e Konferencave të Qendra e Kulturës “Imri Curri” me gjithsej 21 pjesëmarrës/e, prej tyre 7 gra dhe 14 burra. Për prezantimin e Raportit, prezent ishte **Sevdi DERNJANI** (Nënkryetar i Komunës), **Kimete KUKA-HASALLARI** (Drejtores e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale), **Lindita BALLAZHI** (Drejtores për Buxhet dhe Financa), **Majlinda KALOSHI** (Drejtores për Zhvillim Ekonomik), **Natyra KALISI** (Drejtores e Administratës së Përgjithshme), **Arsim DERNJANI** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Abduraman BUSHI** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Hisni LURI** (Drejtor për Arsime, Kulturë, Rini dhe Sport) dhe **Nexhmedin DACI** (Drejtor përbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), si dhe nga Kabineti, zyrtarë të drejtorive përkatëse, si dhe qytetarë nga Hani i Elezit me rrethinë.

Takimin e kryesoi Nënkryetari i Komunës z. **Sevdi DERNJANI**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin publik mbi Raportin e punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023 dhe theksoi se ky raport do të prezentohej nga drejtorët/et komunale.

Me këtë rast, Nënkryetari falënderoi në veçanti zyrtarët komunalë që kanë qenë të drejtëpërdrejtë në kryerjen e punëve duke arritur rezultate, si pasojë e bashkëpunimit të mirë mes stafit ekzekutiv dhe stafit civil.

RENDI I PUNËS

1. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023

Sevdi DERNJANI thekson: Jemi në takimin e dytë me qytetarët për vitin 2023, mbi Raportin e gjashtëmujorit të dytë të punës për vitin 2023, unë do t'i cek disa nga aktivitetet e Kryetarit për vitin 2023, ndërsa ato të drejtorive do t'i prezentojë secili veç e veç. Me fokus të evçantë ka qenë çështja e ujit të pijes, infrastrukturës, shkollimit, si dhe çështje e dukuri tjera që ne vazhdimisht jemi mundu me e bo një përmirësim sa ma të mirë dhe të denjë tek qytetarët. Ndër tjerash kemi pas kontakte të vazhdueshme MMPHI-në, lidhur me një projekt që është duke kalu nëpër qytetin tonë, i cili është rregullimi i infrastrukturës së hekurudhës, kemi bërë përpjekje të vazhdueshme për disa vendkalime dhe ura të cilat janë premtuar prej Ministrisë, por që realisht nuk kemi marr ende një përgjigje konkrete. Ndërsa sa i përket çështjes së ujit të pijes, vazhdimisht Komuna e Hanit të Elezit ka intervenuar dhe kemi çu kërkesa të vazhdueshme në nivel qendror, ndër të tjera me Ministrinë e Ekonomisë kemi pas një bashkëpunim të mirëfilltë, si dhe kemi bërë praninë dorëzimin e fabrikës së ujit në fshatin Dimcë, kjo ka qenë meritë e

ekzekutivit ku me një punë të palodhshme e kemi arrit largimin e CDI-së nga ky ekuacion, ku tash për momentin është në partneritet vetëm Bifurkacioni dhe Komuna Hani i Elezit, ndërsa sot, me rast edhe Kryetarin nuk e kemi prezent në debat, ai momentalisht gjendet në takimin me Bifurkacionin dhe Ministrinë e Ekonomisë ku do të bëhet dorëzimi i të gjitha aseteve të fabrikës së ujit tek Bifurkacioni. Janë bërë investime të vazhdueshme në problematikën kryesore të qytetit që është uji i pijshëm, dhe për vitin 2024 na mbetet vetëm të shohim se si do të funksionojë çështja e menaxhimit të ujit nga Bifurkacioni, sigurisht nuk është kjo për me i ik ne si komunë përgjegjësisë, komuna do të vazhdojë të jetë bashkëinvestuese dhe bashkëpunuese. Poashtu në këtë pjesë do t'i kisha listu marrëveshjet dhe memorandumet e bashkëpunimit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023, të cilat janë: Marrëveshje bashkëpunimi me Agjencionin për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për realizimin e projektit "Ekzodi Billaca 99 - faza e dytë" / Marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për realizimin e aktiviteteve kulturore për nder të bashkëatdhetarëve tanë në diasporë / Marrëveshje bashkëpunimi me Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese - BIRN Kosova, lidhur me auditimin social për projektin "Rregullimi i parkut Isa Berisha" / Marrëveshje bashkëfinancimi me Relief Islamic Kosova në fushën e Shëndetësisë për rekrutimin e tre mjekëve, një laborant teknik, 3 infermierëve dhe 1 shoferi, ku Komuna bashkëfinancoon në shumë rreth 40 mijë € për dy vite / Marrëveshje bashkëfinancimi me Relief Islamic Kosova në fushën e Bujqësisë për subvencionimin e fermerëve me serra me dimensione 5 x 20 m, ku Komuna dhe përfituesit kanë participuar me shumë mbi 30 mijë € / Marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë për Zhvillim Rajonal - Lindje për realizimin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik lokal dhe rajonal / Marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën e Pensionerëve të TKM / FSK dhe Simpatizantëve "ELITA" / Marrëveshje me Zyrën e Bashkimit Evropian për projektin e IPA Fondeve në shumë mbi 728 mijë € për një sistem inteligjent për zbulimin e hershëm të përmblyjeve dhe monitorimin e mbetjeve në pellgun e lumit Lepenc / Memorandum mirëkuptimi me Open Data Kosova për përfshirjen e komunës në platformën Akterët Lokalë / Marrëveshje me 6 përfituesit/et e projektit "Komuna për të Rinjtë - M4Y" - faza e dytë, me subvencionim prej 1,767 € / Marrëveshje mirëkuptimi me SPITALIT SPECIAL PËR REHABILITIM TË PËRGJITHSHËM "BANJA E KLLOKOTIT" SH.P.K për rehabilitimin e shoqatës së pensionerëve, shoqatën Handikos dhe familjet e dëshmorëve / Marrëveshje me Kontigjentin Italian dhe Polak të KFOR-it për dhurimin e defibratorëve, shtretërve dhe dollapëve për çerdhen. Unë në pika të shkurta u mundova me e mbulu aktivitetet e Kryetarit, ndërsa tani secili drejtor/e me radhë, do ta bëjë prezentimin e punës së bërë në drejtoritë e tyre për vitin 2023.

Nexhmedin Daci: Përsëritet për të gjithë. Unë nuk i kam të ndame me gjashtëmujor, meqenëse jemi edhe në fund të vitit, unë do ta paraqes raportin për të gjithë vitin 2023. Po filloj me projektete kapitale ku gjatë vitit 2023 kemi përfunduar projektet: "Ndërtimi i parkut te rruga Lepenci" në shumë 86,387.65 € / "Renovimi i objektit të Komunës" në shumë prej 58,467.00 € / "Rregullimi i parkut në rrugën Isa Berisha - faza e dytë" në shumë prej 44,999.99 € / "Ndërtimi dhe rregullimi i këndëve të lojërave në fshatin Gorancë" në shumë prej 18,161.50 € / "Ndërtimi i aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës" në shumë prej 39,809.80 € / "Rregullimi i varrezave të qytetit" në shumë prej 19,994.05 €, ka përfunduar faza e parë, po shpresoj se në vitin 2024 ose në 2025 do të zhvillohet edhe faza e dytë / "Shtrimi me kubëza betoni i rrugicave në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pustenik, Gorancë dhe Dromjak" i cili është në përfundim e sipër në shumë prej 50,000 € segmenti te fabrika e ujit, ndërkaq segmentet tjera do të vazhdojnë në mars 2024 / "Ndërtimi (rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Paldenicë, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Dimcë, Krivenik" në shumë prej 80,163.25 € / "Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagjen e Re dhe fshatin Paldenicë, Dromjak, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Krivenik, Dimcë" në shumë prej 57,573.91 € / "Rregullimi i prockave dhe i kanalizimeve atmosferike në zonën urbane në rr.Adem

Jashari dhe në fshatin Paldenicë” në shumë prej 71,004.34 € pritet brenda javës të përfundojë edhe ky projekt / “Rregullimi i kanalizimeve në Han të Elezit në rr.Isa Berisha dhe zonat rurale në fshatin Paldenicë, Seçishtë, Dimçë, Pustënik, Gornacë, Dromjak, Krivenik” në shumë prej 31,283.50 €, dy segmente kanë përfundu në Gorancë dhe është punu edhe në Paldenicë, dhe mbetet edhe në zona tjera me u punu gjatë vitit 2024 / “Asfaltimi i rrugës Lagjja Ramukë-fshatin Paldenicë” në shumë prej 211,550 € i cili ka qenë projekt i vitit të kalum / “Ndërtimi i trotuareve për këmbësor në Han të Elezit në rr.Adem Jashari, Udha e Shkronjave, Driton Loku dhe Paldenicë” në shumë prej 23,090 €/ “Kompleksi memorial Bllaca 99 – faza e dytë” në shumë prej 59,086.50 € / “Zgjerimi i rr.Adem Jashari dhe rr.11 Qershori” në shumë prej 60,000 € për vitin 2023 , projekt i paraparë për 3 vite 2023-2024-2025.

Ndërsa sa i përket aktiviteteve tjera, drejtorja ka arritur rezultate shumë të mira. Në sektorin e urbanizimit, të gjitha projektet e realizuara sivjet dhe q po realizohen jan hartu nga sektori i urbanizimit, ka ndihmu pak edhe drejtoresha e zhvillimit ekonomik. Vitin 2023 DUKMM janë dhënë 10 leje ndërtimore dhe tre leje legalizimi me ç’rast janë realizuar të hyra rekorde nga taksa komunale në shumë prej 25,701.57 € apo 71% më shumë se në vitin 2022, ku nga viti paraprak kemi realizuar 3,130 € në emër të taksës për leje ndërtimore dhe çertifikatë të legalizimit. Në kadashtë, në periudhën raportuese, është shtuar vëllimi i punës, janë shtuar numri i lëndëve, si dhe të hyrat në raport me vitin paraprak, ku numri i lëndëve ka shënuar rritje prej 19.5%, nga 1885 lëndë vitin paraprak në 2218 lëndë në vitin aktual, kurse të hyrat janë më të mëdha për 2.5% në raport me vitin paraprak. Në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë kryer 280 inspektime nga inspektorja e mjedisit lidhur me ndalimin e hedhjes së mbeturinave jashtë pikave grumbulluese, pengimin e hedhjes së mbeturinave inerte në natyrë, lum dhe prrocka, kontrollimin e vazhdueshëm të operatorëve ekonomik, gurëthyesve si dhe ndotësve tjerë të ambientit dhe aty ku është parë e arsyeshme janë bërë vërejtje me gojë si dhe 9 gjoaba mandatore, ku gjoaba ma e madhe e shqiptuar ndonjëherë është në shumë prej 500 €, kupër vitin 2023 nga gjobat dhe të hyrat mjedisore janë realizuar të hyra në shumë prej 1,512.53 apo 104.4% më shumë se sa në vitin 2022. Si drejtori për vitin 2023 kemi rritje të hyrave për 94.6% më shumë se viti 2022. Kaq nga DUKMM në pika të shkurta për punën dhe aktivitetet e drejtorisë për vitin 2023.

Natya Kalisi: Përhëndetje të gjithëve! Nga Drejtorja e Administratës së Përgjithshme, për vitin 2024 kemi fillu me realizimin e një objekti dhe obligimi ligjor, pra linja telefonike pa pagesë e cila është funksionalizuar dhe qytetarët mund të kontaktojnë direkt dhe të shpresin pakënaqësitë, kërkesat apo ankesat të cilat i kanë lidhur me çështje të caktuara. Për të vijuar me vendosjen e GPS të automjeteve komunale me qëllim të rritjes së transparencës në përdorim të automjeteve, objektiv i qeverisjes tonë. Në procesin e digitalizimit të sistemit elektronik tashmë ekziston procesi i lëndëve të protokoluara ku qytetarët përmes vegzës në faqen zyrtare mund të klikojnë për të parë lëndën e tyre. Sa i përket konsultimeve publike, sikurse është edhe ky i sotshmi, për të rritur pjesëmarrjen qytetare jemi inkuadruar në Platformën Konsultimet.Rks ku publikohen të gjitha konsultimet publike së bashku me materialin përkatës, përveçse në webfaqen e komunës. Gjithashtu lidhur me konsultimet publike, për të gjithë ata që duan të inkuadrohen në takimet publike për të dhënë rekomandimet e tyre por pa qenë prezent në takim, për këtë qëllim , kemi arritur marrëveshje me Open Data Kosova, ku edhe jemi zyrtarisht pjesë e platformës Akterët Lokal - platformë kjo që mundëson komunikimin e komunës me palët e interesit, kjo është në fazën testuese, mirpo komuna jonë është pilot komunë që po e shfrytëzojmë këtë platformë. Për çdo pyetje, jam e gatshme për përgjigje.

Lindita Ballazhi: Përhëndetje për të gjithë! Në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2023. Drejtorja e Financave kryesisht aktivitetet e veta i ka kryer në katër sektorë: sektori për buxhet, sektori për financa, sektori për të hyra dhe sektori i tatimit në pronë. Buxheti i ndarë për vitin 2023 në bazë të Ligjit të Buxhetit me nr.

02/L-193 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës ishte në lartësi prej 3,349,715 € dhe ekzekutimi i këtij buxheti deri ditën e sotme 26.12.2023 është 3,281,744.91 € apo 90% të realizimit të buxhetit , pasi që buxheti i ndarë sipas Ligjit të Buxhetit është rritur duke përfshirë pranimin e disa donacioneve, bartja e të hyrave të pashfrytëzuara të viteve të kaluara, si dhe donacioni i Qeverisë Japoneze prej rreth 29 mijë €. Pjesë e rëndësishme e punës është edhe inkasimi i tatimit në pronë dhe në tokë, ku gjatë vitit 2023 kemi arritur të inkasojmë 151,771.89 € apo kjo përfshin 63% e planifikimit të kësaj të hyre, ndërsa inkasimi total i të hyrave komunale nga të hyrat direkte pa i përfshirë të hyrat indirekte është 334,022.36 € apo 62% e planifikimit të të hyrave. Aktivitetet e cilat ia vlen të cekem për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023 janë: hartimi i raporteve financiare mujore, tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe 1 vjeçare, ku përfshihen raporte mujore të të hyrave dhe shpenzimeve si dhe aktivitetet tjera të drejtorisë / përgatitja e buxhetit për vitin 2024 dhe parashikimet për vitet 2025-2026 / mbajtja e tetë dëgjimeve buxhetore , ku gjashtë kanë qenë të organizuara nga Zyra e Kryetarit dhe Drejtorisë, si dhe dy të tjerat nga Kuvendi Komunal në bashkëpunim me DBF-në, këto dëgjime buxhetore janë mbajtur me grupe të ndryshme të interesit , si dhe vlen të ceket se nga 11 dëgjime buxhetore në total, tre prej tyre janë mbajtur për Kornizën Afatmesme Buxhetore / takim me forumin e Autoriteteve Komunale rreth Strukturës së Shpenzimeve për vitin 2024 ku janë definuar kufijtë final buxhetor / është bërë futja e të dhënave buxhetore në Sistemin e Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (BDMS) dhe projekteve në sistemin (PIP) / ka filluar procesi i Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit / është dorëzuar buxheti i vitit 2024 dhe parashikimet e hershme për vitet 2025-2026 në Departamentin e Buxhetit – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në afatin e paraparë në bazë të Ligjit / miratimi i propozim vendimit për faljen e faturës së Tatimit në Pronë deri në 100 €, ku këtu isha ndalur që ta jap sqarimin se falja e tatimit në pronë bëhet vetëm për borxhin e vitit 2023 , jo për vitet tjera dhe jo në lartësinë më të madhe se 100 €, ndërsa kamatat dhe intereset , si dhe masat ndëshkuese në rast të mospagesës së faturës së tatimit në pronë do të aplikohen për vitet tjera pra për faturat që janë më të vjetra se viti 2023. Ky ishte një prezantim i shkurtër rreth aktiviteteve dhe punës së drejtorisë, nëse dikush ka ndonjë pyetje , jemi të hapur për diskutime.

Hisni Luri: Ju përshëndes! Puna e bërë për vitin 2023 prej drejtorisë me bashkëpunim me Kuvendin, organizatat, shoqëritë, po i përmendi në vija të trasha: inaugurimi i parkut të SHML Dardania / projekti Drejt Malit nga MASHT / është shënuar Dita Olimpike / Punëtori 3 ditore me nxënësit e SHM Dardania / është mbajtur Festivali Folklorik Mbarëkombëtar Hani i Elezit 2023 / Ndërtuam shkallët emergjente në shkollat shfmu Kështjella e Diturisë dhe shfmu Veli Ballazhi / kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me KFOR-in Italian për pranimin e donacionit – defibrilatorë / shënuam ditët e diasporës me mërgimtarët tanë / shënuam Ditën e Dëshmorëve të qytetit Hani i Elezit / pas përgatitjes për të filluar fillimin e vitit shkollor 2023-2024 / me org USAID/Up to Youth realizuam aktivitete për maturantët, realizimin e sesioneve për shkathtësitë e buta letër motivuese dhe shkrim i CV-ve / kemi përgatit paramasën dhe paralogarinë për projektin Klasa verore me USAID dhe IOM në SHFMU “Veli Ballazhi” / përgatitëm dhe plotësuam Marrëveshjen mes organizatës TOKA dhe Fakultetit të Edukimit, trajnim për mësimdhënësit me metodologji praktike të mësimdhënie për vitin 2024 / pranuan 4 Smart Board-ët për shkollat / kemi shfaqur komedia TUSH&SHIT / realizuam shfaqje per femijët e klasave 3&5 Kutia Empatia / punëtori me HANDKOS, me temën: Gjuha e Lehtë” / zhvilluam nje puntori me org CEDE për prezantimin e projektit nga Caritasi Zvicerrian “Yeni” / realizohet aktiviteti për picture dhe poezi, EX art Colony Hani i Elezit 2023 / jemi të përzgjedhur në fazën e parë nga projektet që Ministria e Ekonomise është duke implementuar për dixhitalizim e shkollave në Kosovë / nënshkruam pranimin e donacionit

(shtretër dhe dollape) për Institucioni Parashkollor Ardhmëria / realizuam programin e festës së nëntorit, ku kishim edhe promovimi i librave të financuar nga Komuna për autorët tanë / nënshkruam pranimin e donacionit nga IOM, për të mbështetur kërkesën tonë, pajjsja e sallës së konferencave / është mbajtur edhe një sesion informues me nxënësit e SHML Dardania / është realizuar trajnimi për mësimdhënës klasorë për fëmijët me nevoja të veqanta / janë kryer me sukses projektet për rregullimin e infrastrukturës shkollore / të rinjtë si mësimdhënës dhe studentët të IT dhe njohës të gjuhëve të huaja nga komuna jonë prezantuan në konferencën DREAMin&LEAP in Kosovo 2023 / nxënësit tanë nga shkolla e mesme Dardania me Eko Klubin e tyre fituan vendin e dytë të aplikuar për çmimin Dervish Rozhaja, ku me shumën e fituar do të investohet në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit ekologjik në qytetin tonë / pranuar donacionin nga USAID-i me org Up to Youth perfaqësuar nga të rinjtë tanë / realizuam marrveshje bashkëpunimi me Shoqatën e Pensionerëve të TMK - FSK dhe Simpatizantëve "Elita", dhe realizuam trajnimin e stafit teknik të shkollave / subvencionuam shtypjen e librit 50 vjet futboll, të prof, Remzi Ballazhi, ku sot ju ftoj të jeni prezent në promovimin e këtij libri në ora 17:00.

Kimete Kuka – Hasallari: Përshëndetje për të gjithë! Atëherë siç edhe e ceku Nënkrjetari në fillim, këtu e kemi përfshirë raportin në pika të shkurta, sepse e kemi inkorporu raportin e drejtorive në kuadër të raportit të kryetarit, ndërsa për raport më të detajuar për aktivitetet dhe punët që i kemi bo do të shfaqen në janar të vitit 2024. Në pika të shkurtra, po i listoj aktivitetet dhe punët që i kemi kry gjatë gjashtëmuajorit të dytë: kemi bërë dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin e të gjitha hapësirave publike në Komunën tonë ; kemi pasur marrveshje bashkëpunimi me Sharrcem të cilët na kanë mbështetur edhe për gjashtë muaj për pjesën e dytë të vitit 2023 për stomatolog dhe infermiere ; kemi pasur mbështetje nga organizata të ndryshme për familjet në nevojë me 160 pako të mishit nga Humanity First Kosova dhe Qatar Charity ; janë mbajtur aktivitete të shumta gjatë muajit Rozë për ndërgjegjësimin e sëmundjes së Kancerit të gjirit si: ekskursion një ditor me gratë e prekura me kancer të gjirit, ligjërata në disa fshatra dhe marrveshjen me Spitalin Rajonal të Ferizajit të mamografisë për 20 gra të komunës sonë ; përfunduar depo në QKMF dhe rregullimi i parkingut para hapësirave në QKMF, si investim kapital në vlerë rreth 31 mijë euro ; në kuadër të marrveshjes mes Islamic Relief dhe Komunës, stafi i parapar ka filluar punën në QKMF për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, 3 mjekë, 3 infermiere, një laborant dhe një shofer të cilët e kanë filluar punën në fillim të muajit dhjetor ; kemi hartuar dy plane shumë të rëndësishme për komunën tonë “Plani kundër dhunës në familje” dhe “Plani i ekipës për të drejtat e fëmijës”. Këto kanë qenë në pika të shkurtra aktivitetet për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2023.

Majlinda Kaloshi: Fillimisht ju uroj mirëseradhje. Ne si drejtori i kemi paraqit disa pika të shkurta të punëve dhe aktiviteteve që i kemi kry, për shkak se materiali është voluminoz dhe nuk mundemi me i përmbledh të gjitha në këtë raport preliminar. Ne kemi fillu me kërkesën për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës, me ç’rast në drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik e kemi shtu departamentin për turizëm, i cili tashmë është edhe i miratuar nga Kuvendi. Kemi hartu Strategjinë për Zhvillim Ekonomik, e që po shpresoj se gjatë mbledhjes së kuvendit në dhjetor do të jetë pikë e rendit të ditës për miratim, dokument i cili përmban të gjitha planet e punës së drejtorisë. Kemi qenë pjesë për hartimin e planit për barazi gjinore, plan i cili ka shumë impakt të madh në komunitet. Sa i përket taksave për ushtrim të veprimtarisë, këtë vit e kemi tejkalu vlerën e inkasimit në krahasim me vitin paraprak. Vitin e kena përmbyll me përfitimin e projektit të IPA Fondeve përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, me donatorë të huaj, ku prezent sot e kemi edhe Amir Qajani i cili ka dhënë shumë kontribut në përfitimin e këtij projekti , ku vlera e projektit arrin shumën mbi 728 mijë €. Realizimi i planit të punës për vitin 2023 në përgjindje shumë të madhe është

realizuar. Diçka që vlen të ceket është se në planin e punës për vitin 2024, si drejtori kemi paraparë ndarjen e subvencioneve për herë të parë nga kjo drejtori, për bizneset fillestare dhe atyre ekzistuese.

Abdurraman Bushi: Përshëndetje për të gjithë! DBPZHR-ja gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, ka kryer aktivitete të shumta sipas planit të punës të paraparë për vitin 2023. Ky raport është raport përmbledhës i aktiviteteve të kësaj drejtorie të realizuar në përmbljesën e objektivave të cilat i ka parashtruar vetes në ofrimin e shërbimeve të qytetarëve. Ky raport është raport përmbledhës i aktiviteteve të kësaj drejtorie të realizuar në përmbljesën e objektivave të cilat i ka parashtruar vetes në ofrimin e shërbimeve të qytetarëve. DBPZHR-ja, aktivitetet i ka zhvilluar në dy sektor të ndryshëm: në sektorin e bujqësisë dhe sektorin e pylltarisë. Në sektorin e bujqësisë janë zhvilluar këto aktivitete për vitin 2023: takime të vazhdueshme në MBPZHR dhe APK ; takime me OJQ, LAB, TIK, CNVP, Mëshjtjerja, Katari, IKC, IADK , etj ; bashkëpunimi me Drejtorit e Bujqësisë të komunave të Republikës së Kosovës ; përgatitja e raporteve për MBPZHR-në, APK-në dhe Inspektoratin e Pylltarisë dhe Gjuetisë ; dorëzimi i kërkesave /projekteve në OJQ dhe Qeveritare për mbështetje të fermerëve ; pjesëmarrja në takime, konference, tryeza të punës, trajnime etj ; përfaqësues i AKK (Asociacioni i Komunave të Kosovës) në Grupin Punues për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim ,në përgatitjen e draft ligjit për rregullimin e tokave bujqësore në Kosovë ; kërkesë në AUVK për kontrollim të gjedhit në Fshatin Paldenicë pas paraqitjes së sëmundjes infektive ‘ BABEZIOZA ’ ; takime me qytetarë dhe fermerë ; pjesëmarrja e rregullt në aktivitetet e ndryshme komunale ; organizimi i subvencioneve direkt nga ministria / pranimi i aplikacioneve dhe dërgimi në ministri për kultura lavërtari, perimtari, blegtori, bletari etj ; përgatitja e raportit të dëmeve të shaktuara nga ariu në bletari ; përgatitja dhe përcjellja e fushatës së korrje-shirjeve ; organizimi panairit të prodhimeve bujqësore dhe artizanale ; dhënia e këshillave për fermerët ; vizita në terren ; subvencionimi i 27 fermerëve me 200€ për mbjellje të grurit, 15 fermerë me 200€ për mbjellje me perime, 84 fermerë kanë përfituar serra me dimensione 100m² ku komuna ka participuar me 3,100 €, nga bashkëpunimi me Islamic Relief Kosova, me ç:rast numri total i fermerëve përfitues nga kategori të ndryshme arrin numrin 151 fermerë. Nga sektori i pylltarisë kemi zhvilluar shumë aktivitete, por i kisha veçuar dy nga aktivitetet më të rëndësishme, ka filluar shitja me pakicë e drunjve të thatë, të thyer dhe mbetheve nga prerësit ilegalë, ku janë shitur 97.45 m³ me çmim 16€/m³, si dhe aktiviteti tjetër i rëndësishëm është pyllëzimi i kodrës së Shullanit në Seçishtë, ku janë mbjellë 20 fidane të pishës, kurse pjesa tjetër mbetet për vitin e ardhshëm.

- **Diskutimi**

Sevdi Dernjani: Pas prezantimit të raportit të secilës drejtori nga drejtorët dhe drejtoret, e hap diskutimin mbi Raportin e punës së ekzekutivit për vitin 2023.

Resul Suma – asambleist në Kuvendin Komunal Hani i Elezit: Prezantimi ishte shumë i mirë. Një pyetje për DUKMM, sa % është shpenzu buxheti për investimet kapitale, a do të mrrihet granti? Si dhe një pyetje për DAP, tash kanë ardh edhe shumë bashkëatdhetarë dhe po shoh se ka shumë ankesa sa i përket shërbimeve në administratë, a keni marr ndonjë veprim që me u bo këto vendimet që s’janë tu i lshu për këto shërbimet që s’ po jepen?

Nexhmedin Daci: Sa i përket shpenzimit të mjeteve të investimeve kapitale me ato projekte që janë realizu është mirri granti, ndërsa këto të hyrat vetanake janë arrit mbi 85%. Shpenzimi i buxhetit me përqindje nuk

bëhet vetëm nga një drejtori, por besoj se e kemi tejkalu 85%. Në krahasim me vitin e kaluar jemi ma mirë.

Natya Kalisi: Para se me u përgjigj, deshta me u drejtu me një pyetje, se ku po ankohen qytetarët, te ti apo ku, sepse ankesat me protokol te drejtorja e administratës ku gjatë muajit ka qenë vetëm një ankesë. Sa i përket zgjidhjes, ne zgjidhjen e kemi bo, kështu që kushdo që ka nevojë për shërbim të caktuar, e bën kërkesën te gjendja civile pranohet kërkesa dhe jepet vendimi.

Resul Suma– asambleist në Kuvendin Komunal Hani i Elezit: Meqë drejtori i DSHPE s’ gjendet, po ju drejtohem juve si nënkryetar, lidhur me çështjen e ujit, a po bëhet me pagesë apo jo, sepse Bifurkacioni sa e kam pa unë ka fillu me i marr do numra , ka shumë diskutime prej qytetarëve për këtë çështje, është edhe mungesë e transparencës edhe prej juve edhe prej Bifurkacionit.

Sevdi Dernjani: Ndonjëherë mundohemi që sqarimet me i dhanë në pika të gjana, por realisht kur po shkojmë në pika të gjana , absorbimi i të kuptuarit është shumë ma i vogël. Nëse shkojmë në pika të shkurta, prapë se prapë keni me thanë që nuk ka shumë informacion. Ne gjatë gjithë vitit, jemi mundu me e informu në të gjitha mënyrat qytetarin e Komunës së Hanit të Elezit për çështjen e ujit. Prej fillimit kemi thënë dhe në çdo diskutim që na është bo pyetje për çështjen e ujit e kemi potencu, madje edhe në fillim të këtij takimi, nëse keni dëgju e përmenda që në fillim ka qenë e inkuadrume CDI-ja, ne e kemi largu CDI-në prej këtij ekuacioni , tashti për momentin janë vetëm Bifurkacioni dhe Komuna e Hanit të Elezit. Sot, arsyeja që Kryetari i Komunës dhe drejtori i DSHPE-së nuk gjendet në këto momente në debat, është sepse të dy janë në ambientet e fabrikës së ujit, ku në këto momente edhe po bëhet pranim dorëzimi i të gjitha asetëve të fabrikës së ujësjetillës në fshatin Dimcë, do të thotë do të kalojë në menaxhim të plotë të Bifurkacionit. Gjatë gjithë vitit 2023, janë bo investime të vazhdueshme nga Komuna e Hanit të Elezit të i përket ormatësve , këtu sigurisht ka pas probleme , ka pas edhe mungesë të ujit, por jemi pranë një procesi që ne duhemi me e kuptu. A ka ujë? Realisht nuk ka pas ujë. A do të ketë ujë? Nuk e dimë. Unë prapë po e them, jemi pranë një procesi që duhemi me pas durim për me pa rezultatin. Sot do të bëhet pranim dorëzimi i të gjitha asetëve tek menaxhimi i Bifurkacionit, do të dalim me një njoftim publik ku Bifurkacioni do të thotë se komplet menaxhimin e ujit në Han të Elezit do ta ketë Bifurkacioni dhe ankesat e qytetarëve duhet të drejtohen në Bifurkacion, ndërsa Komuna në varësi të kërkesave të Bifurkacionit do të investojë. Kurse me pyetjen se a do të ketë pagesa apo nuk do të ketë pagesa, ne e kemi diskutu edhe ma herët. Gjatë këtij njoftimi që do të bëhet nga Bifurkacioni, prapë do të potencohet se nuk do të ketë pagesë derisa nuk hyn në sistem procesi i furnizimit të rregullt me ujë. Ndoshta do ta ketë tarife fikse, 1€ e pak për orën që e kanë vendos, ndërsa nuk do të ketë faturë për ujin e shpenzuar gjatë muajit dhjetor. Gjatë muajit janar, Bifurkacioni do ta ketë një afat kohor që do të bëjë thirrje për të gjithë qytetarët që janë të interesuar për me u inkuadru në ujësjetillësin e fshatit Dimcë. Ata që nuk do të inkuadrohen, do të pasohet me gjoba dhe me një tarifë shtesë për inkuadrimin të orëmatësve. Kjo është përgjigja, nëse mendon që isha i qartë , mundem prapë me e sqaru.

Resul Suma– asambleist në Kuvendin Komunal Hani i Elezit: A mendon që uji është i pijshëm?

Sevdi Dernjani: Unë mendoj që uji është i pijshëm prej fabrikës nalt, pra uji i pijshëm del prej fabrikës, ndërsa gjatë rrjetit që ne e kemi në Han të Elezit, mundet që nëpër shpja mos me qenë i pijshëm. Në këto momente, ne s’po themi që uji është i pijshëm, por është e rëndësishme që si proces me u inkuadru çdo qytetarë në rrjetin e ujësjetillësit dhe po bëj thirrje me këtë rast tek çdo qytetar, tek çdo subjekt, tek çdo parti politik,e tek çdo organizatë e gjithkund që me ndodh inkuadrimi në ujësjetillës nga të gjithë.

Xhevahir Dernjani – asambleist në Kuvendin Komunal Hani i Elezit: Përshëndetje të pranishmit, kryetarit, nënkryetarit, drejtorive, kolegëve asambleistë dhe gjithë të pranishmit. Meqenëse edhe dy ditë e kemi mbledhjen e Kuvendit komunal, ju përgëzoj për punën që e keni bo si ekzekutiv, ku shumë kërkesa dhe nevoja të qytetarëve ne si asambleistë i kemi paraqit dhe po realizohen. Siç e ceku edhe drejtori i DUKMM, po punohet te kanalizimi i ri në Paldenicë , ku e shoh se banorët që e kanë kërkuar këtë projekt janë nda shumë të kënaqur me pranimin e kërkesës së tyre, ku kjo kërkesë ka qenë edhe ma herët. Janë kry edhe punë tjera, kam qenë edhe vet në terren tek disa prej tyre. Për dy vjet, besoj se si Kryetari, po edhe si ekzekutiv është punu mjaft mirë, edhe ne si asambleistë jemi mundu me i përfaqësu sa ma mirë dhe sa ma shumë qytetarët. Meqenëse do t'i diskutojmë edhe në Kuvend, ju uroj punë të mbarë dhe suksese.


Sevdi Dernjani: A keni edhe ndonjë diskutim për Raportin që u prezentua sot? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur Debatin publik.

Mbledhja përfundoi në ora 11:20.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi

Nënkryetari i Komunës
Sevdi Dernjani





**Lista e pjesëmarrësve – takim i dytë me qytetarë lidhur me Raportin e punës së
Kryetarit të Komunës për 2023**

Data: 26.12.2023

Ora: 10:30

Vendi: Salla e Konferencave – Shtëpia e Kulturës

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita/Institucioni/Vendi	Telefoni	Nënshkrimi
1	REMI BUSHI	ZYRRARI TI KASABER	046/6191402	Remi Bushi
2	Natirra Kullisi	DAP	045 1213 639	Natirra Kullisi
3	DAJEN XHONI	SHML DREKOVINA	044 354 001	Dajen Xhoni
4	Agim Bushi		045 408 915	Agim Bushi
5	Shkurt Demiri	Zyra Priftiq	046-192-997	Shkurt Demiri
6	Resul Sumg	Kuvend Komunal	046 - 134 - 554	Resul Sumg
7	Abdurrahman Bushi	Drejton	046 928 600	Abdurrahman Bushi
8	ARSIM DERVISI	OSHPK	045-308-843	Arsim Derisi
9	Shems Guri	OKAES	044 909 734	Shems Guri
10	LINDONA BHALITON	Z. Kryetarit	044/862-571	Lindona Bhaliton
11	AMIRI BIRRI	Kuvend	044/200-363	Amiri Birri
12	MARLINDA MURDHI	DENET	049/434-659	Marlinda Murdhi
13	Lindita Bekvari	DBT	045/522-400	Lindita Bekvari
14	Alimet Kuka	OSHPK	049-691-560	Alimet Kuka
15	BARUSH LAGI	ZYRA UGDRE	044 446 887	Barush Lagi
16	IKBERHAR DEMIRI	ASAMBLE	044.227.599	Ikberhar Demiri
17	Betire Demiri	Zyrtare e Bujmeve dhe Rreze	044/489-307	Betire Demiri
18	SEVIME RAJRAMI	Zyrtare Financare	044/956162	Sevime Rajrami
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				
30				
31				
32				